



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.01.2021, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 14.12.2020 dhe 22.12.2020.
2. Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integritit Europian për periudhën 18 janar – 15 shkurt.
3. Projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka, Kostaq Papa, Arlind Çaçani, Edlira Hyseni, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Artemis Dralo Malo, Ilir Pendavinji dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Sadri Abazi, Ralf Gjoni, Fatmir Velaj, Musa Ulqini dhe Taulant Balla.

Të ftuar:

Etjen Xhafaj – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Irena Manolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Blerta Xhaku – Drejtor për çështjet juridike dhe integrimin pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale.
Zef Mazi – Kryenegociator i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian

Ami Kozeli – Këshilltari i Kryenegociatorit i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin
European

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e
Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Meqenëse sot është mbledhja e parë e Komisionit për Integrimin European për këtë sesion, unë ju uroj një sesion të mbarë, sigurisht, edhe një vit të mbarë dhe me shëndet!

Me sa duket jo vetëm sot, por edhe në vijim mbledhjet e komisionit do të zhvillohen nga unë, në rolin e nënkryetares së Komisionit të Integritimit European. Sikurse e keni marrë axhendën në postën tuaj elektronike, në rendin e ditës kemi shqyrtim miratimin e procesverbaleve të datave 14.12.2020 dhe 22.12.2020; miratimin e kalendarit të Komisionit të Integritimit European për periudhën 18 janar - 15 shkurt, dua këtu të propozoj edhe shtesën e një projektligji që do të diskutojmë sot, pikërisht për marrëveshjen IPA II ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit European në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, si dhe dy projektligjet përkatëse, projektligjit që i referohet marrëveshjes IPA dhe projektligjit “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Me ne sot të pranishëm janë përfaqësues nga të dyja ministritë. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për sa i përket projektligjit “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” të ftuar kemi zotin Etjen Xhafaj, zëvendësministër; zonjën Irena Manolli, drejtoreshë, dhe zonjën Blerta Xhaku për çështjet juridike. Ndërkohë, për marrëveshjen IPA kemi të pranishëm zotin Zef Mazi, kryenegociator i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European së bashku me stafin e tij, këshilltarin e kryenegociatorit, Ami Kozeli, dhe Daniela Çekanin, drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Pa humbur kohë, do të kalojmë në miratimin e procesverbaleve të datave 14.12.2020 dhe 22.12.2020. Kush është dakord me procesverbalet? Dakord!

Miratohen.

Në lidhje me miratimin e kalendarit të komisionit, sikurse e keni të depozituar në postën tuaj elektronike plus edhe marrëveshjen IPA për programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, a jeni dakord, të nderuar kolegë? Dakord!

Miratohet.

Atëherë, pa humbur kohë, dua t’ua kaloj fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të na shpjeguar projektligjin “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ku është risia, qëllimi dhe...*(nuk dëgjohet)*.

Zoti Xhafaj, fjala është për ju.

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Faleminderit, nënkryetare!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” është, në fakt, një plotësim i kuadrit ligjor në fushën e shoqërisë së informacionit dhe synon të nxisë zhvillimin e ekonomisë së të dhënave, pra ekonomisë dixhitale.

Projektligji synon transpozimin e direktivës së BE-së 2019/1024 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 20 qershor 2019 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Kjo iniciativë ligjore është në përputhje me angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në veçanti me nenin 103 të MSA-së, ku parashikohet përfarimi gradual i legjislacionit kombëtar në fushën e shoqërisë së informacionit me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian. Miratimi i legjislacionit për të dhënat e hapura, sipas praktikës europiane, është në objektivat e politikës për të dhënat e hapura, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.02.2015, “Për miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura”. Plotësimi i këtij kuadri ligjor për të dhënat e hapura është në harmoni edhe me angazhimet për *Open Government Partnership* dhe me praktikën më të mirë të zhvilluar deri tani në këtë drejtim.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit përmes përdorimit të gjerë të aplikacioneve inovatore dhe të dhënat e hapura ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e ekonomisë dixhitale. Informacioni i sektorit publik përbën në vetvete një burim të jashtëzakonshëm të dhënash që përmes ripërdorimit të tyre, pra si informacioni që vjen nga shërbimet publike, ashtu edhe ai që vjen nga kompanitë apo shoqëritë anonime, të cilat janë në funksion të misionit publik, mund të ripërdoren dhe të japin një kontribut të rëndësishëm për krijimin e aplikacioneve të reja, për zhvillimin e ekonomisë së të dhënave dhe për zhvillimin tregut të brendshëm.

Zbatimi i të dhënave të hapura dhe ripërdorimi i informacionit publik parashikonte dhe kërkonte përshtatjen e legjislacionit të duhur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e BE-së. Ky projektligj përcakton bazën ligjore për përdorimin e të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, me qëllim nxitjen e inovacionit si në produkte, ashtu edhe në shërbime.

Projektligji është propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë, si institucioni drejtues për kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” dhe është hartuar me kontributin e veçantë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Projektligji ka kaluar në një proces konsultimi të gjerë përmes regjistrimit

të konsultimit publik, konsultimit institucional dhe, gjithashtu, kemi pasur komunikime të vazhdueshme si me Komisionin Europian, si me ekspertët e *Digi Connect*, dhe *Digi Nie* dhe asistencë teknike nga TAJEX.

Unë po e mbyll këtu dhe jam në dispozicionin tuaj, në qoftë se keni pyetje të mëtejshme.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Nëse anëtarët e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, që janë pjesëmarrës në këtë komision, kanë nevojë apo duan të shtojnë ndonjë gjë tjetër, mund të flasin?

Zonja Irena? zonja Blerta?

Irena Malolli – Nëse është e nevojshme, ne jemi në dispozicion për të dhënë përgjigje për çdo pyetje ose sqarim të nevojshëm. Ajo që mund të shtoj është që nga Komisioneri dhe grupi i punës janë shqyrtuar edhe praktikatat e vendeve të tjera dhe është parë që transpozimi i kësaj direktive në një pjesë të mirë të vendeve të BE-së, si Gjermania, Italia, Greqia, Malta, e kanë bërë me ligj të veçantë, ashtu sikurse ka edhe vende të tjera që e kanë integruar në ligjin e të drejtës së informimit. Në praktikën shqiptare, nga analiza që është bërë, është parë me vend kalimi në një ligj të posaçëm.

Senida Mesi – Ju falënderoj!

Atëherë, të nderuar kolegë, hapim diskutimet ose pyetjet, nëse keni, në lidhje me projektligjin drejtuar përfaqësuesve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës.

Atëherë, përveç Edlirës, nuk shikoj ndonjë dorë tjetër.

Zonja Edlira, fjala është për ju.

Edlira Hyseni – Faleminderit!

Përshëndetje!

Në përmbajtje dhe në tërësi ligji nuk mendoj se përbën ndonjë arsye për ta kundërshtuar, por dua të kuptoj më thjesht dy gjëra, meqenëse edhe ata që na ndjekin duan të kuptojnë se çfarë ligji po kalojnë.

Në radhë të parë, dua të di është një ligj që, ashtu siç ju e thatë i përfron pjesërisht, sepse kemi raportin e përfrimit që na ka ardhur sot, pjesërisht direktivës së BE-së, që është mjaft e re, pra e vitit 2019. Pyetja e parë është: përtej angazhimeve të marra në nivel kombëtar, strategjik të përfrimit që ne po bëjmë, për çfarë lind në Shqipëri kjo nevojë? Nëse keni mundësi, na e ilustroni me një shembull konkret praktik, , për shembull, si do të jetë një dokument i sektorit publik, që mund të ripërdoret dhe nga kush? Pra, ne duam diçka konkrete,

që të kuptojmë për çfarë po e bëjmë këtë ligj dhe çfarë të mire do të ketë interesi publik apo Shqipëria nga ky ligj i ri.

Pyetja tjetër, me aq sa lexova dhe për aq sa ne arrijmë ta kuptojmë në thelb, dua të di, ky ripërdorimin e dokumenteve shtetërore, pra i dokumenteve që zotërojnë institucionet shtetërore, pasi i kalon njëherë palë me kërkesë, kjo palë a ka drejtë ta kalojë te palët e tjera pa pasur nevojë të informojë? Pra, këtë informacion, që bëhet i hapur, i disponueshëm dhe kalon nga një institucion publik te një privat (sepse kanë të drejtë subjektet fizike dhe juridike, thamë privat apo shtetëror, që ta përdorin këtë dokument), a kanë të drejtë këta që e kanë fituar herën e parë ta transferojnë apo ta riprodhojnë për çdo lloj qëllimi, apo kanë ndonjë kufizim në përcjelljen dhe transferimin e tyre?

Pyetja tjetër lidhet me penalitetet e gjobave, që i keni marrë në konsideratë në nenin 17, të cilat janë mjaftë të larta nëse nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji. Çfarë keni pasur parasysh kur keni vlerësuar masat e gjobave, të cilat janë të konsiderueshme dhe si janë gjykuar ato?

Kam edhe një pyetje për ligjin në tërësi. Ligji në tërësi parashikon që do të hyjë në fuqi 2 vjet pas publikimit në Fletoren Zyrtare. Pra, ligji parashikohet të të fillojë zbatimin në vitin 2023. Përse është menduar të caktohet ky afat?

Dy pyetjet e tjera janë më të thjeshta, pra janë të natyrës teknike. Unë i referohem nenit 7 dhe nenit 9. Në nenin 7 flitet për trajtimin e kërkesës dhe në pikën 4, ku thuhet: “Sipërmarrjet publike, institucionet arsimore dhe disa organizata nuk e kanë detyrimin për të zbatuar këtë nen”. Ky nen flet për trajtimin e kërkesës që bëhet për 15 ditë, për 20 ditë e të tjerë, pra sipas rasteve. Çfarë do të thotë që disa institucione nuk e zbatojnë këtë nen? Pra, unë nuk e kuptoj pikën 4, çfarë nuk do të zbatojnë këto institucione? Pra, këto institucione nuk kanë afate për përgjigje ndaj kërkesave që marrin? Nuk e kam të qartë këtë nen.

Neni 9 flet për koston e ripërdorimit. Pra, ripërdorimi i dokumenteve që merren nga institucionet shtetërore parimisht është gratis, por mund të aplikohen tarifa kur ka kosto për riprodhimin apo përpunimin e tyre.

Te pika 3 e nenit 7 thuhet: “Bëjnë përjashtim nga ofrimi i dokumenteve pa pagesë...” pra përjashtohet mundësia për t’i dhënë këto dokumente pa pagesë, “...organet shtetërore, të sektorit publik, sipërmarrjet publike dhe biblioteka”. Pra, kush ngeli për t’i bërë pa pagesë?! Nëse te pika 3 përjashtohen të gjithë ata që bëhet ky ligj, që janë institucionet shtetërore, ata nuk e kanë opsionin për t’i bërë pa pagesë, të paktën kështu e kuptoj unë pikën 3, cili mbetet për t’i bërë pa pagesë? Unë këto kisha.

Nuk jam kundër ligjit, por dua të kuptoj nevojën praktike, të mirat që sjell për interesin e përgjithshëm, përse bëhet i nevojshëm në këtë moment dhe pse do të fillojë pas 2 vjetësh zbatimi i tij?

Faleminderit!

Irena Malolli – Faleminderit!

Unë do të bëj një sqarim të përgjithshëm për pyetjet që u shtruan. Pastaj, këtu me mua është përfaqësuesja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, e cila mund të japë shpjegime më të detajuara.

Lidhur me pyetjen e parë, për direktivën e Bashkimit Europian, që është e vitit 2019 dhe përse ne e kemi këtë angazhim, unë dua të bëj një sqarim: direktiva për të dhënat e hapura dhe për të drejtën e përdorimit të informacionit publik në Bashkimin Europian, direktiva e parë, daton në vitin 2003 dhe ka pasur një amendim të mëvonshëm, në vitin 2010 ose në vitin 2013, në mos gaboj. Puna për të bërë transpozimin e kësaj direktive, që mund të ishte e vetmja në direktiva përpara vitit 2013, e patransfuzuar në kapitullin 8, ka nisur herët, menjëherë pas miratimit të dokumentit të politikave, që u përmend nga zëvendësministri, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147 në shkurt të vitit 2015. Në kuadër të transpozimit të direktivës, që ka qenë në atë kohë në fuqi, kemi marrë dhe asistencën e Dajevsit.

Në vitin 2019 ne kemi pasur takimin shpjegues për kapitullin 10 me ekspertët e DG Connect, në DG NEAR, në Bruksel, ku në veçanti ka pasur një seancë shpjeguese dhe për dispozitat e direktivës, për të dhënat e hapura dhe të drejtën e ripërdorimit. Në veçanti nga pala shqiptare, ku përfaqësuesit kanë qenë edhe nga ministria jonë, edhe nga Komisioneri, edhe nga institucionet e tjera, që kanë aktivitet në fushën e axhendës digjitale, është bërë pyetja: jemi në këtë proces, kemi një punë të nisur për transpozimin e direktivës së vjetër të të dhënave të hapura, cili është sugjerimi juaj? Ekspertët e Bashkimit Europian na kanë sugjeruar që, meqenëse ndryshimet në direktivën e re nuk janë shumë esenciale kundrejt praktikës që kishte të vendosur prej gati 10 vjetësh Bashkimi Europian, të veprojmë me direktivën e re që ka hyrë në fuqi. Në këtë kontekst ne morëm përsipër të analizonim dhe të merrnim në konsideratë direktivën e re.

Përse e ka periudhën e gjatë të tranzicionit? Risia në direktivën e re është pikërisht parashikimi i përdorimit të të dhënave të hapura përmes mekanizmave të programit të app-it, që është shkëmbimi i të dhënave në mënyrë dinamike e të tjera.

Ku është mundësia e madhe e përdorimit të tyre? Të dhënat e hapura më tipike janë të dhënat gjeohapësinore dhe ne, nga analiza që kemi bërë dhe që është shumë e detajuar dhe prezantuar në dokumentin e impaktit rregullator, kemi dhënë disa shifra shumë domethënëse,

se sa shpejt janë rritur përdoruesit e të dhënave të hapura të gjeoportalit në një kohë shumë të shkurtër kohore. Nga momenti i implementimit të gjeoportalit nga ASIG-u, ka pasur 4-fishim të përdoruesve të këtyre të dhënave, që janë një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e aplikacioneve dhe mundësive të reja të biznesit. Ne jemi prezent dhe jemi përdorues të aplikacioneve të shumta, që përdorin të dhënat e gjeo-location. Rastet e ripërdorimit, janë të dhëna të publikuara nga INSTAT-i, që është një nga grupet kryesore të të dhënave të hapura.

Shembuj të tjerë, praktika ndërkombëtare dhe vendet që i kanë tashmë të zhvilluara, janë pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë, përfshirë të dhënat e transportit publik, të dhënat në fushën e energjisë dhe zakonisht në sektorët që ofrojnë shërbime të interesit të përgjithshëm.

Për sa i përket nivelit të gjobave, përfaqësuesja e komisionerit mund të na japë një shpjegim. Në dijeninë tonë, për sa kemi qenë pjesë e diskutimeve, ato janë mbështetur në një praktikë që ekziston, në një legjislacion aktual, dhe ndoshta është ndjekur i njëjti nivel për sa u përket atyre.

Për dy pyetjet e ngritura të posaçme për nenet 7 dhe 9, me sa shikoj unë, formulimet në pikën 4 të nenit 7 kanë të bëjnë me mosdetyrimin dhe barrën e institucioneve që përmenden, me përjashtim për afatet e ngushta, sepse bëhet fjalë për një kategori të caktuar institucionesh, dhe te neni 9, për koston e ripërdorimit mbahen parasysh specifikat që ata mund të kenë në një legjislacion të posaçëm.

Për shembull, termi “të dhënat e hapura” gjendet edhe në ligjin e posaçëm që ka ASIG, por është i kufizuar dhe ka disa nocione ose përkufizime të caktuara.

Në vazhdim, drejtoresha Juridike e Komisionerit mund t’ju japë një shpjegim për nivelin e gjobave.

Faleminderit!

Blerta Xhako – Përshëndetje!

Ju falënderoj për pyetjet!

Unë jam Blerta Xhako, drejtoreshë Juridike pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Do të doja të theksoja se, ndër të tjera, Zyra e Komisionerit është zgjedhur autoritet mbikëqyrës për zbatimin dhe monitorimin e këtij ligji, sepse vetë direktiva për të drejtën e ripërdorimit të informacionit publik dhe të dhënat e hapura adreson institucionin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe institucionin përgjegjës për akses në informacion, që të mbikëqyrë vetveten për ripërdorim të informacionit publik.

Për sa i përket pyetjes për sanksionin, sikundër e tha edhe kolegia Irena, ne e kemi vendosur në bazë të një praktike të konsoliduar, referuar ligjit për të drejtën e informimit. Në pikën 2 të projektligjit është vendosur një pikë, ku parashikohet se masat administrative ndaj organit të sektorit publik ose sipërmarrjeve publike do të vendosen ose do të jenë proporcionale me dëmin e shkeljeve të shkaktuara.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

Zoti Kasneci, do të doja t’jua kaloja fjalën për përafrimin e këtij ligji me direktivën përkatëse të Bashkimit European. Ju keni bërë komentet tuaja, ku sugjeroni ndryshimet. Do të doja të dija nëse keni dakordësi me ministrinë për të kaluar këtë projektligj në votim.

Fjala për ju, zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – E nderuar, zonja zëvendëskryetare,

Të nderuar deputetë,

Siç u prezantua nga përfaqësuesit e qeverisë, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të Komisionerit, projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” ka si qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit këshilltar me legjislacionin e Bashkimit European, për atë që quhet, në mënyrë të përmbledhur, “fusha e tregut të informacionit”.

Konkretisht, projektligji është përafuar pjesërisht me direktivën e BE-së, nr. 1024, të datës 20 qershor 2019 “Për të dhënat e hapura dhe përdorimin e informacionit në sektorin publik”.

Siç u prezantua, kjo direktivë është pjesë e një pakete masash ligjore që ka ndërmarrë BE-ja në kuadër të realizimit të tregut të brendshëm dixhital, ose *digital single market*. Qëllimi është të forcohet ekonomia e të dhënave të BE-së, duke përfshirë shumë aspekte, por ndër to, shumë e rëndësishme është ajo që quhet “inteligjenca artificiale”.

Të nderuar deputetë,

Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, në mbështetje të veprimtarisë suaj, ka analizuar përputhshmërinë e neneve të projektligjit me nenet përkatëse me direktivën për një përafrim më korrekt. Përafrimi ka qenë i bërë shumë mirë, por për përafrim më korrekt, ne kemi sugjeruar në total 7 vërejtje.

Për ekonomi të kohës suaj, ne i kemi diskutuar paraprakisht me përfaqësuesit e ministrisë, dhe kemi gjetur dakordësi.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin!

Nëse është e nevojshme, mund të japim detaje të mëtejshme, por kemi gjetur dakordësi me përfaqësuesit e qeverisë për vërejtjet tona. Faleminderit!

Senida Mesi – Të falënderoj, zoti Kasneci!

Nëse nuk keni pyetje apo diskutime, të kalojmë në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”?

Miratohet në parim.

Faleminderit!

Për sa u përket ndryshimeve të propozuara nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit me BE-në dhe *acqui*-në, kemi dakordësi me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Sikurse është procedura, do të kalojmë nen për nen dhe në tërësi, me propozimet e rena dakord nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

Kush është dakord?

Kolegët anëtarë të komisionit, të cilësi nuk duken në kamera, ju lutem, shprehni dakordësinë! Hapni kamerën ose flisni.

Mirela Kumbaro – Jam dakord.

Senida Mesi – Artemisa, jeni dakord?

Ilir Pendavinji– Dakord.

Senida Mesi – Faleminderit, Ilir.

Zonja Malo, të shprehet nëse është dakord.

Besoj se nuk është e pranishme.

Sekretariati, jemi në rregull me numrin për aprovim?

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord?

Shikoj të gjitha duart e ngritura.

Besoj se zonja Kumbaro, Vasil Sterjovski ...

Mirela Kumbaro – Dakord.

Senida Mesi – Faleminderit!

Miratohet projektligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.01.2021, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka, Kostaq Papa, Arlind Çaçani, Edlira Hyseni, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Artemis Dralo Malo, Ilir Pendavinji dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Sadri Abazi, Ralf Gjoni, Fatmir Velaj, Musa Ulqini dhe Taulant Balla.

Të ftuar:

Zef Mazi – Kryenegociator i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian

Ami Kozeli – Këshilltari i Kryenegociatorit i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Senida Mesi - Kalojmë te projektligji tjetër i agjendës për sot “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

I falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, të cilët mund të largohen!

Faleminderit, zoti Xhafaj, zonja Malolli dhe zonja Xhako!

Etjen Xhafaj – Faleminderit, e nderuar!

Ditë të mbarë!

Senida Mesi – Edhe ju!

Në lidhje me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”, do të doja t’ia kaloja fjalën zotit Mazi për një shpjegim të kësaj projekt marrëveshjeje dhe më pas do të keni mundësi të shpreheni nëse keni pyetje apo diskutime.

Urdhëroni, zoti Mazi!

Zef Mazi – Mirëdita!

Faleminderit, zonja nënkryetare e komisionit!

Së pari, meqenëse kjo është mbledhja e parë për këtë vit dëshiroj të theksoj rëndësinë që ka dimensionin parlamentar për ecurinë e vendit tonë drejt integrimit europian.

Për këtë rëndësi të madhe që ka ky dimension gjej vend të vlerësoj rolin e gjithë komisioneve parlamentare të vendit dhe në mënyrë të posaçme Komisionin e Integritimit. Rëndësia e mbështetjes dhe mirëkuptimit të këtij komisioni është mjaft me rëndësi për procesin në të cilin vendi ynë ka hyrë me një intensitet shumë të lartë.

Qëllimi i këtij projektligji është të ratifikojë marrëveshjen e financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.949, datë 2.12.2020 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të

asistencës së paraaderimit (IPA II)” dhe është nënshkruar nga koordinatori kombëtar i IPA-s në datën 17.12.2020.

Programet kombëtare vjetore nën IPA sanksionohen në rregulloren zbatuese të IPA II të BE-së që mban numrin 447/2014, datë 2.5.2014, si dhe në marrëveshjen kuadër mes Shqipërisë dhe Komisionit Europian “Për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.37/2015, datë 9.4.2015.

Kostoja totale e llogaritur e programit IPA 2019 është 71 milionë e 905 mijë euro dhe kontributi maksimal i unionit për këtë program, gjithashtu, është vendosur në 70 milionë e 650 mijë euro.

Ky program kërkon kontribut financiar nga përfitues të fondeve IPA II, siç është Shqipëria në këtë rast, dhe BE-ja.

Asistenca IPA II është programuar për një periudhë 7-vjeçare, 2014-2020, me fokus arritjen e objektivave dhe politikave sektoriale dhe rezultateve që janë të rëndësishme për anëtarësimin. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Komisionin Europian është hartuar dokumenti indikativ kombëtar 2014-2020. Dokumenti strategjik përcakton prioritetet e asistencës financiare të BE-së për periudhën 2014-2020 për të mbështetur Shqipërinë drejt anëtarësimit në BE.

Edhe objektivat, po ashtu, janë përcaktuar, identifikohen aksionet dhe aktorët kryesorë, përshkruan rezultatet e pritshme, tregohet se si do të matet dhe monitorizohet progresi, përcaktohen alokimet financiare indikative.

Procesi programues për programin vjetor IPA 2019 ka nisur në muajin korrik 2018, janë identifikuar prioritetet për mbështetje nga zyra mbështetëse e koordinorit kombëtar të IPA-ve në bashkëpunim me zyrën e Kryeministrit, Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, si dhe me Delegacionin e BE-së në Tiranë.

Pas konsultimeve u vendos që sektorët që do të merrnin mbështetje për IPA 2019 do të ishin arsimiti, punësimi dhe politikat sociale nëpërmjet “Mbështetje e BE-së për përfshirjen sociale” dhe mjedisi përmes “Mbështetje për sektorin e mjedisit” duke u përqendruar në ekonominë qarkulluese.

Si rezultat i procesit të programimit, zyra mbështetëse e koordinorit kombëtar të IPA-ve, në bashkëpunim me përfituesit, hartuan dy dokumente veprimi. Në nëntor të vitit 2019, Komisioni Europian miratoi me vendim të posaçëm paketën e programit IPA 2019 me kosto 70 milionë e 650 mijë euro.

Programi “BE për përfshirjen sociale” do të zbatohet në një kosto prej 50 milionë euro në programin “Mbështetje për ekonominë qarkulluese” do të zbatohet me kosto 20,65 milionë euro.

Referuar situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, si dhe pasojat e Covid 19, ndër të tjera, KE-ja vendosi ta mbështesë Shqipërinë përmes rialokimit të fondeve IPA 2019, më konkretisht, i atashuan shumat e sipërcituara hartimit të propozimeve që do të lehtësonin pasojat ekonomike dhe sociale.

Pra, programi IPA 2019 do të zbatohet përmes veprimit “BE për përfshirjen sociale”, që ka si objektiv të përgjithshëm të zgjerojë mbulimin, gjithpërfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj emergjencave të shërbimeve të kujdesit social, arsimin parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinj dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

Më konkretisht, programi vjetor IPA 2019 do të realizohet nëpërmjet mbështetjes buxhetore me 50,65 milionë euro me menaxhim direkt nga delegacioni i BE-së.

Kjo shumë do të kalojë në buxhetin e shtetit në bazë të përqindjes së realizimit të treguesve të kontratës së reformës sektoriale përkatëse.

Objektivi i përgjithshëm i mbështetjes buxhetore është zgjerimi i mbulimit, gjithpërfshirja, efektiviteti dhe përballimi i emergjencave në shërbimet e kujdesit social, arsimit parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

Së dyti, prokurime me 8,7 milionë euro me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Delegacioni i BE-së priten të lëshohen tre ose më shumë procedura prokurimi për asistencë teknike, në lidhje me mbështetjen e institucioneve përgjegjëse për përfshirjen sociale, punësimin dhe arsimin parauniversitar.

3. Grantet. Me menaxhim të drejtpërdrejtë dhe me menaxhim të tërthortë. 2 milion euro me menaxhim të tërthortë dhe 9, 3 milionë euro me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Delegacioni i Bashkimit European.

Për herë të parë nga një program IPA kombëtare, përfituese nga granti do të jenë edhe bashkitë e përzgjedhura. Janë 19 bashki të cilat, në rast se do të jenë fituese të granteve, do të jenë të detyruara të paguajnë 10 % të koston totale të grantit.

Mendoj se do të ishte në interesin e komisionit, që të mësojë se si janë përzgjedhur dhe si mund të përfitojnë bashkitë nga thirrjet e propozimet për grante. Rastet e vetme kur bashkitë mund të jenë përfituese nga fondet e grantit të këtij programi, janë ato që synojnë të përmirësojnë e të rrisin nivelin e shërbimeve dhe partneriteteve të qeverisjes vendore. Të tilla

janë grantet prej 9, 3 milionë eurosh, siç i përmenda më lart, me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Delegacioni i Bashkimit European.

Granti do të jetë i hapur për 19 bashki. Koncretisht, bashkitë janë: Përrenjas, Gjirokastrë, Vlorë, Mallakastër, Cërrik, Librazhd, Shijak, Kavajë, Kurbin, Kukës, Krujë, Pogradec, Korçë, Kamëz, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Durrës, Tiranë.

Këto janë përzgjedhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit European, mbi bazën e disa kriterëve që lidhen me shkallën e varfërisë, kërkesat për punësim, kriteri demografik, struktura e ekonomisë lokale, niveli i dhënies së shërbimeve.

Përfituesit e IPA 2 janë të detyruar të financojnë, siç e përmenda më lart, 10 % të kostos së grantit që do të jenë përfitues. Në këtë kontekst, dukem qenë se edhe bashkitë janë përfituese nga këto grante, do të duhet që ato të sigurojnë 10 % të fondeve të grantit, nga buxheti i tyre.

Aktualisht, nuk është e përcaktuar kostoja që është detyrim i shtetit tonë. Ky përcaktim do të bëhet pasi të kryhen procedurat e nxjerrjes së thirrjeve për propozime, si dhe të jenë përcaktuar bashkitë fituese.

Në kushtet kur nxjerrja e thirrjes për këto grante është planifikuar të jetë në fillim të këtij viti dhe në fund të vitit 2022, përfshirja në buxhet e bashkive fituese do të realizohet në momentin e aplikimit për këto grante. Përfshirja e 10-përqindëshit në buxhetin përkatës të bashkive do të kryhet gjatë rishikimit të aplikimeve dhe rregullave të hartimit të buxhetit. Do të jetë e njëjta praktikë si në programet e IPA-s dhe bashkëpunimit ndërkufitar.

Institucionet përfituese nga ky program janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Për herë të parë në një program vjetor IPA, përfitues janë bashkitë, siç e thashë, dhe shoqëria civile, nëpërmjet thirrjeve për propozime për grante. Veprimi mbështet zbatimin e strategjisë kombëtare për mbrojtjen sociale, si dhe strategjinë kombëtare të punësimit e të aftësive.

Ky ishte raporti që kishim përgatitur, zonja zëvendëskryetare e komisionit.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Senida Mesi – Ju falënderoj, zoti Mazi!

Në fakt, do të doja, ose më mirë të them, të komentoja në lidhje me raportin. Ne, si komision, nuk e kemi një raport të tillë, ndaj do t'ju lutesha, nëse është e mundur, që të na e dërgoni me postë elektronike, pasi është shumë i detajuar dhe do të na ndihmonte ne anëtarëve të komisionit, për të kaluar në detaje, le të themi. Në një moment të dytë, të volitshëm për të dyja palët, të ulemi dhe të rishikojmë problematikat në një seancë dëgjimore, mbase edhe me

bashkitë specifike, për të mësuar në lidhje me problematikat. Një nga problematikat që di unë personalisht, është pikërisht parashikimi në buxhet i 10-përqindëshit. Në dijeninë time, shumica e bashkive nuk e kanë parashikuar një buxhet të tillë në lidhje me buxhetet e tyre lokale. Pra bashkitë, në nivel lokal, kur miratojnë buxhetin e tyre, mbase e kanë të pamundur, që me të ardhurat që kanë, të parashikojnë se sa projekte mund të fitojnë, të çfarë volumi mund të jenë këto projekte, për të parashikuar pastaj edhe një fond rezervë ose një fond të dedikuar, një zë të dedikuar në lidhje me këtë 10-përqindësh.

Nga ana tjetër, ju komentuat se kjo do të parashikohet ose do të mbulohet nga Ministria e Financës, pra nga buxheti i shtetit, jo në 2021-shin, por ndoshta në rishikim të 2021-shit dhe në vitin 2022, pra si rimbursim i vitit 2021. Nëse unë e kam kuptuar qartë.

Në lidhje me projekt marrëveshjen me Bashkimin European, besoj se pikat që ju sapo parashtruat, që sapo na i prezantuan, kanë të bëjnë me programin e ri që keni miratuar në bashkëpunim me Bashkimin European dhe me ministritë. Sepse, më duket sikur u referohemi vitit 2019, por po flasim për zbatimin në vitin 2021 e 2022. Kjo vetëm si sqarim për kolegët deputetë, por edhe për ata që na dëgjojnë.

Kolegë deputetë, keni ndonjë koment tjetër, para se t'ia kalojmë fjalën zotit Mazi? Nuk shoh duar të ngritura.

Po, zoti Mazi, një koment, nëse mundeni!

Zef Mazi – Faleminderit!

Siç e theksova në raportin që mbajta, të cilin sigurisht që do t'jua dërgoj, do t'i kërkoj zyrës që t'jua dërgojë menjëherë, që ju ta shpërndani tek anëtarët e komisionit, pa asnjë problem, pra siç e theksova, nuk është përcaktuar kostoja që është detyrim i shtetit tonë. Ky përcaktim do të bëhet pasi të kryhen procedurat e nxjerrjes së thirrjeve për propozime, si dhe të jenë përcaktuar edhe bashkitë fituese. Pasi të dihet se cila bashki është përfituese, atëherë do të parashikohet praktikisht nga bashkitë. Do të ishte jokorrekte t'i kërkohej një bashkie, që të përcaktonte një buxhet plus për të mbuluar një 10-përqindësh, nëse ajo nuk e di nëse do ta fitojë grantin apo jo. Prandaj është lënë në këtë formë, sepse të tilla janë edhe procedurat e Komisionit European.

Unë e theksova, ju me të drejtë e kapët pikën, por po e them edhe një herë siç e thashë: në kushtet kur nxjerrja e thirrjes për këto grante është planifikuar të jetë në fillim të këtij viti dhe në fund të vitit 2022, përfshirja në buxhet e bashkive fituese do të realizohet në momentin e aplikimit për këtë grant. Sepse ai do që ta dijë: po aplikoj për një grant që ka këtë shumë. Në këtë mënyrë do të ketë mundësi ta llogarisë, që nëse e fiton, buxheti plus prej 10-përqindësh do të jetë aq. Nuk e di nëse jam i qartë apo jo.

Në lidhje me pikën që ju përmendët, për vitin 2019, në vitin 2021 kemi hyrë, mund të bëj një sqarim për komisionin, e besoj se kjo do të jetë edhe për projekte të tjera, për marrëveshje të tjera. Projekti i vjetër kombëtar organizohet nëpërmjet një kalendari programues, që përcaktohet nga Komisioni Europian, nga vendet përfituese, i përfaqësuar nga koordinatori kombëtar. Një proces programues zgjat si praktikë një vit e gjysmë. Arsyet janë: koha që i duhet për hartimin e dokumenteve të veprimit; pjesa e programit; koha që u duhet strukturave të komisionit për ta miratuar paketën dhe hartimin e marrëveshjes përkatëse financiare. Të gjitha këto bashkë shkojnë si procedurë, si praktikë rreth një vit e gjysmë. Pavarësisht viteve buxhetore, përkatëse zonja kryetare, zbatimi operacional, kontraktimi i alokimeve vjetore bëhet deri 3 vjet pas vitit kalendarik, sipas modalitetit të Komisionit Europian, që njihet si rregulli n +3. Pra, viti buxhetor ka mospërputhje me vitin kalendarik. Këto janë modalitetet e Komisionit Europian dhe besoj se jua thashë qartësisht, ekzaktësisht si janë modalitetet, me qëllim që komisioni të ketë dijeni të plotë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Mazi!

Po, zonja Hyseni. Keni pyetje, apo diskutim?

Edlira Hyseni – Faleminderit!

Kam një pyetje të thjeshtë: është një marrëveshje e rëndësishme, një ndihmë e madhe që BE-ja i jep sërish vendit tonë, prandaj është për t'u vlerësuar, sepse fondet, ky instrument i ndihmës financiare të paraanëtarësimit ka disa vjet që funksionon dhe, realisht, të kalojmë dhe të miratojmë sot sërish një kontribut të madh që BE-ja po na jep edhe në këtë situatë të vështirë, është vërtet është një lajm i mirë.

Janë rreth 72 milionë euro, në mos gaboj, në total, 71 milionë e 950 euro, nga të cilat buxhetit të Shqipërisë do t'i kushtojë afërsisht vetëm 1,2 milionë euro, pjesa tjetër është financim i Komisionit Europian, pra një ndihmë e madhe që na jepet e fokusuar, siç thoni, në arsim, punësim dhe politikat sociale.

Më vjen mirë që janë 19 bashki të përfshira në mundësitë e përfitimit, por kam idenë sikur dhamë më tepër informacion për grantin 9 milionë euro, se sa për 60 milionë euro të tjera, që, në fakt, përbëjnë shumën e konsiderueshme të ndihmës që po marrim. Grantet absolutisht janë të rëndësishme dhe shpresojmë që bashkitë të jenë në gjendje që t'i përthithin ato në vlerat e tyre të plota. Prita me padurim nëse ishte edhe Durrësi. Ishte edhe Bashkia e Durrësit; e lexuat të fundit, prandaj mendova se Bashkia e Durrësit nuk kishte nevojë për grante, por më vjen mirë që do të jetë edhe Durrësi. Objektivi, nëse e dëgjova mirë, ishte përforcimi i shërbimeve publike, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike që nuk mendoj

se ka ndonjë bashki që nuk ka nevojë t'i përmirësojë ato. Problemi i 10%-shit nuk më duket i madh, sepse, e para, nëse themi 9 milionë euro janë grante në garë për 19 bashki, duke menduar të jenë fituese të gjitha, i bie diku te 500 mijë euro për bashki, 10%- shi i 50 mijë eurove nuk më duket kosto e papërbalueshme për kundërt ndihmës së madhe që u jepet bashkive nëpërmjet këtyre granteve. Shpresoj që bashkitë të jenë të organizuara e t'i shfrytëzojnë ato në masën 100%.

Në relacionin që shoqëron, ka një raport që e kanë sjellë sot, flitet më fjalë të përgjithshme, shumë fjalë dhe pak shifra. Në aspektin tim profesional preferoj shifrat, ndërkohë që relacioni, që e shoqëron, është fjalëshumë, por ka pak shifra. Mund të kuptoj si do të përdoren fondet që po vijnë për ndihmë për arsimin dhe politikën sociale, por ishte edhe punësimi. Më intereson të di ndonjë gjë më konkrete sesi mund të ndihmohet, se si mund të implementohen këtë herë këto fonde të reja për punësimin, përtej arsimit dhe politikave sociale që duken më të kuptueshme sesi mund të përdoren fondet, do të doja të kuptoja nëse ka një ide pak më praktike, më konkrete se si këto ndihma do të shkojnë për punësimin, sidomos të të rinjve, shpresoj të grave për fuqizimin e tyre, sepse di që ka diçka, e cila lidhet me barazinë gjinore dhe fondet që shkojnë specifikisht për gratë. A keni diçka më konkrete se si do të implementohen ato në lidhje me punësimin?

Pyetja e fundit; këta 72 milionë janë deri në vitin 2024, pra për 4-5 vjetët e ardhshëm? A keni një ide sesa do të jenë konkretisht? Mund të kemi ndonjë parashikim, apo ndonjë pritshmëri sesa do të jenë për këtë vit që flasim këto fonde, sa do të arrihen të përthithen, apo nuk bëjmë dot një parashikim të tillë?

Faleminderit!

Zef Mazi – Faleminderit për komentet dhe pyetjet!

Janë shumë të hollësishme. Kur po dëgjoja komentet tuaja, po mendoja se jam në Komisionin për Ekonominë dhe vetë nuk jam ekonomist.

Totali është aq sa thashë, 70 milionë. Këto janë të ndara në 50 milionë, që janë me menaxhim direkt nga unioni, janë të ndara në 8,7 milionë, që janë me menaxhim të drejtpërdrejtë po përsëri nga delegacioni dhe në grante, që janë me menaxhim të tërthortë dhe me menaxhim të drejtpërdrejtë. Këto bashki janë selektuar, siç thashë, nga një procedurë që është përcaktuar midis vendit tonë dhe delegacionit të BE-së, janë të njohura këto procedura se si përcaktohen dhe është vështirë t'i ndërrosh modalitetet e Komisionit. Është hera e parë që kontribuojmë me 10%, sepse jemi në një stad tjetër, më përpara kanë qenë pa kontribute financiare të shtetit që përfitonte grantet. Kontributet financiare, kur kontribuon shteti, tregojnë seriozitetin e shtetit, në këtë rast të bashkive, përfituesve, tregojnë edhe vazhdimësinë e

ndjekjes së projektit deri në përfundim të tij. Për të gjitha këto grante unë e kam të vështirë, Daniela mund të japë më tepër saktësi, të them sesi do të ndahen për secilën bashki, sepse nuk janë lëshuar të gjitha thirrjet për këto ente. Kur të shikojmë thirrjet, do të jetë e qartë se çfarë përmban secila, çfarë do të arrihet, me sa fonde do të përfundojë, cili do të ishte grupi i kompanive që bashkia e ka caktuar, sa do t'i bëjë vetë me departamentet e saj, sa do t'i japë sektorit privat, social, OJQ-ve e të tjera. Sot unë e kam të vështirë ta them se sa konkretisht.

Për sugjerimin që bëtë për Durrësin keni të drejtë. Do t'i kërkoj stafit, pasi dy prej tyre janë në linjë, që herë tjetër, kur ka rreshtime të qyteteve, krahinave, zonave e të tjerë, të përdoret rendi alfabetik. Kjo do të ishte më e saktë.

Nuk e di nëse Daniela mund të më sqarojë diçka më shumë, më konkretisht për pyetjen që bëri zonja Hyseni.

Daniela Çekani – Po, zoti kryenegociator, faleminderit!!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Unë do të tentoj t'i jap përgjigje zonjës Hyseni. Siç e përmendi që në fillim edhe zoti Mazi, e gjithë mbështetja financiare e BE-së për vitin 2018 shkon në mbështetje të strategjisë kombëtare, ku përfshihet edhe punësimi. Një nga modalitetet është pikërisht mbështetja buxhetore sektoriale që është edhe pjesa më e konsiderueshme e kësaj ndihme, 80 milionë euro. Kjo mbështetje buxhetore sektoriale nënkupton kalimin e të gjithë fondit të unionit në buxhetin e shtetit, bazuar në disa aktivitete specifike kryesore dhe indikatorëve të përcaktuara nga institucionet përfituese mbi bazën e të cilave do të bëhet edhe përthithja e fondeve të BE-së.

Duke qenë se pas dhe gjatë miratimit të marrëveshjes financiare kemi edhe dokumente të tjera veprimi, mbi të cilat kjo marrëveshje do të zbatohet, një prej të cilave është edhe kontrata e reformës sektoriale, mbështetja buxhetore, janë të përcaktuara në tabela të mirëfillta të gjithë indikatorët që qeveria shqiptare duhet të përcaktojë, duke u bazuar edhe në afatet kohore të caktuara mbi bazën e të cilës do të zbatohet në vijimësi kjo mbështetje financiare nga BE-ja. Me të vërtetë që kontraktimi i këtyre fondeve presupozohet të ndodhë gjatë 3 vjetëve në vijim, por siç jua thashë, si pjesë e dokumentacionit më specifik, të cilin ne jemi shumë të hapur ta ndajmë me ju, duke përcaktuar kohën dhe indikatorët specifikë mbi të cilën kjo përthithje do të ndodhë, ku, gjithashtu, do të përfshihet edhe aspekti i punësimit, pasi ne sot informacionin e kemi të përgjithshëm se çfarë marrëveshja mbulon në tërësinë e saj, por për këtë do të na duhen indikatorë specifikë që merren me punësimin. Sa i takon kësaj, ne jemi shumë të hapur që t'ju përcjellim edhe një informacion tjetër më të detajuar në kontekstin e punësimit më vete.

Kjo është një marrëveshje vjetore, siç e përmendi zoti Mazi, për vitin 2019, e cila do të pasohet edhe nga marrëveshje të tjera në perspektivën financiare IPA II, konkretisht ajo e vitit

2020. Ndërkohë që ne planifikojmë dhe miratojmë marrëveshjet vjetore financiare bëhet zbatimi i atyre para ekzistuese.

Pra, në momentin që ne në muajt në vijim do të miratojmë marrëveshjen e vitit 2020, marrëveshja e vitit 2019 si marrëveshje do të zbatohet deri në 3 vjet më pas. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me vitin 2020. Presupozohet që ky fond do të thithet brenda vitit aktual ku jemi, por faktikisht është deri në 3 vjet dhe të gjitha afatet për këtë përthithje janë përcaktuar në dokumente specifike veprimi.

Besoj se ju kam dhënë një sqarim të detajuar, megjithatë jemi të hapur që për çdo pyetje specifike informacionin t'ju përcjell edhe me shkrim.

Senida Mesi – Shumë faleminderit!

Në fakt, ju na dhatë një informacion shtesë, por besoj se kolegët e komisionit do të dëshironin të kishim edhe më shumë informacion, pasi bëhet fjalë për një marrëveshje tjetër, ajo e vitit 2020, e cila do të vijë përsëri në komisionin tonë në momentin që do të bëhet gati nga ju.

Besoj se entet përfituese mund të aplikojnë paralelisht në të dyja këto programe. Pra, për sa kohë që njëri nga këto programe zgjat 3 vjet, a është e mundur që këto ente të aplikojnë edhe për programin e vitit 2019 dhe për programin e vitit 2020, në momentin që do të aprovohet edhe marrëveshja e vitit 2020?

Daniela Çekani – Po, zonja kryetare.

Në fakt, procesi i programimit për programet kombëtare vjetore është bërë tashmë përfshirë vitin 2020. Ne jemi në momentin kur kjo marrëveshje po kalon procedurat e brendshme të konsultimit me institucionet e linjës dhe pritet të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave në muajin mars. Shpresojmë të arrijmë ta miratojmë në parlament përpara mbylljes së sesionit parlamentar, por, gjithsesi, kjo marrëveshje, edhe me miratimin e Këshillit të Ministrave, hyn në fuqi menjëherë pas firmosje nga pala e fundit, që është vendi përfitues, Shqipëria, me firmën e kryenegociatorit dhe koordinatorit kombëtar të fondeve IPA, zotit Mazi. Përmbajtja e marrëveshjes tashmë është e finalizuar.

Senida Mesi – Pyetja ime kishte të bënte me faktin që a përfitojnë entet. Pra, bashkitë apo institucionet mund të aplikojnë në të dyja fondet, pra edhe kur të aprovohet viti 2020 për grantet, sipas ligjeve përkatëse.

Daniela Çekani – Pikërisht.

Pas lançimit të bërë për projektpropozime në varësi të objektivit të përgjithshëm dhe specifik do të jenë të hapura me kritere të përcaktuara qartë dhe nën vëzhgimin e Komisionit European.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

Po, zoti Mazi.

Zef Mazi – Dua të shtoj vetëm një fjali.

Kjo gjë kërkon një koordinim mjaft të mirë të kërkesave ndërmjet ministrive përkatëse. Të gjithë ministrat përkatës dhe negociatorët, të cilët janë zëvendësministrat, në grup janë në dijeni ose janë vënë në dijeni dhe për 6-mujorin e fundit të vitit që sapo mbyllëm janë angazhuar direkt për këtë punë. Në rast se në vijim do të kemi moskordinime, besoj se ju e keni parasysh, sepse do të jetë shumë e vështirë nëse procedurat janë mbyllur të futen gjëra të tjera.

Të gjitha bashkitë, edhe ministrinë, e dinë që, kur bëhet një koordinim i tillë, patjetër që rezultati është më i lartë dhe përfitimi më i madh.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Mazi!

Sikurse u diskutua dhe u dakordësua në komision në lidhje me relacionin që na bëri prezent zoti Mazi, si dhe me shtesat që na bëri zonja Daniela, do të dëshironim që pranë sekretarit me *e-mail* ose me shkrim të na depozitoheshin brenda një afati të pranueshëm edhe për ju, pra deri sa dokumentacioni të jetë gati, besoj brenda javës, me qëllim që dokumentacioni i depozituar nga ana juaj t’u shpërndahet nga sekretariati të gjithë anëtarëve të komisionit.

Pa humbur kohë po kaloj për miratim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

Kush është dakord në parim?

Ilir Pendavinji – Dakord.

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Pendavinji!

Klodiana Spahiu – Dakord.

Senida Mesi – Faleminderit, zonja Spahiu!

Shoh që të gjithë i kanë duart e ngritura.

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin nen për nen të projektligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Shoh të gjithë duart e ngritura si dhe konfirmimin e zotit Pendavinji dhe të zonjës Spahiu me zë.

Miratohet në tërësi projektligji.

Projektligji i miratuar është gati për të kaluar në seancën plenare të radhës, sipas kalendarit të aprovuar edhe nga Konferenca e Kryetarëve.

Falënderoj shumë zotin Mazi dhe stafin që e shoqëron për pjesëmarrjen dhe sqarimet!

Të nderuar kolegë deputetë, nëse nuk keni pyetje apo diskutime të tjera, këtë mbledhje e deklaroj të mbyllur!

Faleminderit dhe ditë të mirë!

MBYLLET MBLEDHJA